



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Borezuar Prilbena / Pridato Received / Delivered	07.08.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedimica Org / Unit	Nr Prot fu Prot Prot No	Shprehje Pritjeje Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKOC	5559/2023		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.310/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2248/2020 të datës 21.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.140/23 të datës 02.005.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.317/2020 të datës 22.10.2020 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.08.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.317/2020 e datës 22.10.2020 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 13-112/12-0026563/20 i datës 22.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2014 në pozitën "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm", më datë 22.10.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2186/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që nuk është shqyrtuar ankesa për harmonizimin e pagës për pozitën "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.12.2020 ka nxjerr Vendim A.nr.317/2020 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit. Ankuesi kundër këtij vendimi



ka hapur konflikt administrativ në gjykatën kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.12.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2248/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimin e Këshillit dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi, më datë 16.02.2023 Këshilli ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative më datë 02.05.2023 ka nxjerr Aktgjykim AA.nr.140/23 me të cilin ka refuzuar ankesën e Këshillit duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Kërkesën e datës 22.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 25.06.2020 e ankuesit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 13-112/0026563/20 i datës 22.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës; Dëftesën për pranimin e dërgesës i datës 25.06.2020; Plotësimin e lëndës nga ankuesi më datë 02.11.2020; Autorizimin e datës 04.06.2020; Dëftesën për pranimin e dërgesës e datës 20.10.2020; Formulari i shpenzimit i datës 30.09.2020 nga Komuna e Podujevës; Akt Emërimit e ankuesit i datës 01.02.2014; Listat e pagave nga muaji janar 2012 deri janar 2020; Aktgjykimin A.nr.2248/2020 të datës 21.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.140/23 të datës 02.05.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi më datë 09.06.2020 ka parashtruar ankesë për harmonizimin e pagës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës, më datë 22.06.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 13-112/12-0026563/20 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër këtij vendimi nëpërmjet postës më datë 25.06.2020 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, mirëpo në Dëftesën për Pranimin e Dërgesës së Postës adresa ku do të duhej dërgohej ankesa shkruan \_\_\_\_\_ dhe nuk është adresa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nuk ka asnjë dëshmi që ankesa e ankuesit është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi më datë 22.10.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin e ankesës së datës 25.06.2020, ku në kërkesë thuhet: “  
*nga \_\_\_\_\_ më datë 25.06.2020 ka ushtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Nr. 13-112/12-0026563/20 të dt 22.06.2020 dhe ka theksuar se me aktvendimin e cekur i është refuzuar ankesa e parashtruar nga \_\_\_\_\_ për harmonizimin-unifikimin e pagës në pozitën e Udhëheqësi të Auditimit të Brendshëm dhe se ankesa është dorëzuar përmes pozitës me të njëjtën datë. Mirëpo deri me tani organi juaj nuk ka*



*vendosur sipas ankesës së ushtruar andaj kërkojmë që në afatin shtesë prej 7 ditësh për zgjedhjen e kësaj çështje përndryshe kjo do të konsiderohet si aprovim i kërkesës me heshtje administrative sipas nenit 98 para 2 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe ne do ti drejtohem organeve tjera dhe në procedurë tjetër për realizimin e kërkesës tonë sipas dispozitave ligjore”.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në aktgjykimet e cekura si më lartë, ka bërë rishqyrtimin e ankesës së ankuesit, i cili pretendon se Komuna e Podujevës nuk ka bërë kompensimin diferencës së pagës për punë e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm prej datës 01.01.2012 deri më datë 01.02.2014, për unifikimin e pagës për pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm prej datës 01.02.2014 deri më datës 30.06.2020.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, konstaton se meqë ankuesi pretendimet e ngritura i ka për periudhën nga data 01.01.2012 deri më datë 30.06.2020, atëherë sipas nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”,* si rrjedhojë në bazë të provave të lëndës, nuk është gjetar asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ndonjë kërkesë apo ankesë tek autoriteti punëdhënës për realizimin e të drejtës së tij brenda kësaj periudhe kohore, ndërsa këtë e ka bërë vetëm në kohën kur ka parashtruar ankesën e datës 09.06.2020 pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Nga konstatimi si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit për kompensimin diferencës së pagës prej datës 01.01.2012 deri më datë 30.06.2020, në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës është e parashkruar, ngase kanë kaluar më shumë se tri vite nga koha e lidhjes së kontratës apo akt emërimit dhe nuk janë ndërmarr veprimet juridike, ndërlidhur me afatin e përcaktuar me dispozitat e cekura si më lartë respektivisht afatin tri vjeçar të parashtrimit të kërkesës është konstatuar me Aktgjykimin A.A.nr.749/2022 të datës 30.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ku theksohet se: *“nëse kalon afati prej tri viteve sa është afati i parashkrimit për këto kërkesa dhe nëse është parashtruar pas afatit prej tri viteve nga momenti i kalimit të një muaji nga lidhja e kërkesës atëherë kërkesa është e parashkruar dhe nuk mund të realizohet”,* kështu që pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës me rastin e vendimmarrjes sipas Vendimit me Nr. 13-112/12-0026563/20 të datës 22.06.2020 ka theksuar faktin se nuk janë ndërmarr veprimet me kohë, mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës ka vendosur në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin së më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave. Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.




Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

*Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.310/2023**

**Avdyl BEKTESHI**  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të ankuesit .
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

